

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER BELINDA V. ÇELAJ



V2020050310138284821

DATE 06/11/2020
NR REP 2441

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 06.11.2020, para meje Notere BELINDA V. ÇELAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.3/118, u paraqit personalisht:


DEKLARUES/I

Raffaele Attianese, i datelindjes 01/12/1966, lindur dhe banues ne Itali, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporte nr. YB3143234.

Saverio Francesco Vacca, i datelindjes 16/09/1975, lindur dhe banues ne Itali, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporte nr. YA5770003.

Deklatuesit e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “**STATUTIN DHE AKTHEMELIMIN TE SHOQUERISE TREGTARE “Motraco Albania” Sh.p.k** bashkelidhur.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërrma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënavë Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.





**STATUT E AKTHEMELIMI
SHOQUERISE TREGTARE
“Motraco Albania” Sh.p.k**

KREU I

**EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA
NENI 1**

Ne Tirane, sot me daten 06/11/2020 (dymijeenjezet), shtetasit:

- Raffaele Attianese, i datelindjes 01/12/1966, lindur dhe banues ne Itali, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte nr. YB3143234.
- Saverio Francesco Vacca, i datelindjes 16/09/1975, lindur dhe banues ne Itali, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporte nr. YA5770003.

Me vullnet t^e lire t^e plete si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen jane ortak vendosen te hartojne kete Statut e Aktthemelimi mbeshtetur ne nenet e meposhtme e si dhe ne dispozitat ligjore si; Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ligjin me nr 9901 date 14.04.2008 “PËR TREGTARET E SHOQUERITE TREGTARE”

NENI 2

Shoqeria tregtare eshte vendase dhe emerohet “Motraco Albania” Sh.p.k emertim i cili do t^e jetë i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia e shoqerise “Motraco Albania” Sh.p.k eshte ne Tirane, Rruga “Nikolla Tupe”, nr. 2/3/6.

NENI 4

Shoqeria “Motraco Albania” Sh.p.k do te kete si objekt te veprimtarise te saj;

Konsulence per kërkim, zhvillim te tregut te hidrokarbureve, ndermjetesim per blerje dhe shitje te karburatit dhe gazit. Kompania mund t^e marre pjese ne tenderat e hidrokarbureve. Mundet gjithashtu te bleje ose te beje licenca te kesaj fushe. Shoqeria do te kryeje t^e gjitha operacionet e biznesit, finanziar dhe insustrial si dhe te letrave me vlere, te cilat jane te nevojshme dhe/ apo t^e dobishme per objektivat e shoqerise. Shoqeria do te marre dhe do te ofroje garanci p^r hua dhe do te ofroje obligacione per palet e treta, kompanive t^e tjera q^e kanë ose jo objekt t^e ngjashem me te. Shoqeria gjithashtu do te operoje ne tregun e pasurive te paluajtshme.

NENI 5


Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 124.000 leke (njeqinenjezetekatermije) formuar dhe nenshkruar nga ortaket ne 2 kuota si me poshte;

- Raffaele Attianese zoterues i 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 50 %.
- Saverio Francesco Vacca zoterues i 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 50 %.

I depozituar sipas ligjit.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.



Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte i papercaktuar duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit ne QKR, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

KREU II KUSHTET EKONOMIKE

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj. Ortaket dhe administratori i saj, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria .

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaket kane të drejtë të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre e perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjesave të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Notarial dhe per nje gje të tille vendimet e asamblese se ortakeve te shoqerise duhet të merren paraprakisht me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sa po t'u behen të ditura.

NENI 10

Me vendim të ortakeve te shoqerise, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime të tjera të cilat jane me interes per mbarvajtjen e shoqerise.

NENI 11

Shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose disa ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtar si brenda vendit dhe jashte saj.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISE DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKES TË VETME



NENI 12

Asambleja e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji ne fuqi. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 13

Administrator i shoqerise eshte Z. Raffaele Attianese, me pashaporte nr. YB3143234 me afat 5- vjecar . Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithe juridiksonin territorial të Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anullohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 14

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit ne QKR, per njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar të kesaj qendre.

Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë rregistruar dhe paisur me certifikatat perkatese ne Organin e Tatim Taksave Tirane.

NENI 15

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe ate Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike per ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarise se saj, mbi bazen e Aktit të Themelimi dhe Statutit të saj dhe normat e se drejtes tregtare nderkombetare.

NENI 16

Asambleja e Ortakeve e shoqerise ka dhe keto të drejta dhe detyra kryesore :

- Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Të kerkoje dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe kane të bjene me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo per cdo llogari të celur

si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese. Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tij.

- Të kryeje sherbime per realizimin e objektivave dhe qellimeve të veprimtarise se rregullt ligjore të Shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon ne cdo kohe Administratorin e shoqerise, cakton ekspertin kontabel të autorizuar. Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon per prestatjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ekonomiko financiar të aktivitetit të shoqerise, të cilin ia paraqesin ortakeve mbi bazen e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortaket kane të drejten e miratimit vendimor të këtij bilanci.

Nxjerra e bilancit financiar vjetor mbi bazen e të dhenave të kontabilitetit, behet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Asambleja e Ortakeve kryesisht si dhe Administratori, ushtrojne dhe keto të drejta :

Mundesohen per të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane të domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarise tregtare të shoqerise sipas qellimeve dhe objektivave të saj sic mund të jene:

- Të lidhin kontrata të ndryshme qe kane per objekt blerjen, shitjen, kembimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridike, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe ne rast të blerjes se pasurive të paluajtshme, të bejne dhe transkriptimin e pronesise se saj ne favorin e tyre ne Hipoteken e ZRPP, per të dokumentuar nje rrethane të tille dhe si shtese të kapitalit ne natyre.
- Të kryeje cdo lloj veprimi prane të gjitha zyrave private dhe shteterore, Bankat e cdo nivelit etj. qe kane të bejne me Garancite, sipermarjet, marrjen e kredive, siguracioneve, transportit brenda dhe jashte shtetit), per zhdonimin e mallrave të importuara apo eksportuara, ate të plotesimit me korektese të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes ne kohe të cdo detyrimi. Ne rastet kur keto veprime juridike kryhen nga administratori i emeruar nga ortaku i vetem ose personi qe e perfaqeson ate mbi bazen e prokures, keta ne perfundim të realizimit të veprimit perkates detyrohen qe të njoftojne menjehere dhe t'i japin llogari ortakut te vetem.

Administratori ose perfaquesuesi me prokure jane individualisht pergjegjes ndaj shoqerise apo të treteve, per veprime të kryera ne shkelje të ligjeve dhe qe bien ne kundershtim me kete Statut dhe per demin e shkaktuar me faj, sipas rastit, Ortaku mund të ngreje dhe të kerkoje ndaj tyre padi per shlyerjen e demit civil, duke perfshire dhe të drejten per të bere kallezim per ndjekje penale ne Prokurorine e juridikacionit tokesor ku ka seline shoqeria

NENI 17

Perfaqesimi i shoqerise ne mardheniet me të tretet si brenda dhe jashte shtetit si rregull dhe per gjithshem i perket Administratorit te shoqerise.

NENI 18

Asambleja e Ortakeve, kane të drejte qe per nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqerise, të marrin ne pune shtetas të ndryshem, madhor dhe me zotesi të plete per të vepruar, duke lidhur kontrate sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Ri te Punes ne fuqi dhe me ligjin nr. 7703 date 11.05.1993 " Per sigurimet shoqerore " te ndryshuar si dhe ne pershatje me rregullat e brendshme të disiplines teknike dhe të punes të caktuara nga vete punedhenesi.

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko financiare të shoqerise, mbyllen me daten 31 Dhjetor të cdo viti. Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivit dhe pasivit ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakes të vetme. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakes se vetme per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe kane.

NENI 20

Nxjerra e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimitari tregtare.

NENI 21

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortakut, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimitarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 22

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

NENI 23

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene :

- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimitarise se saj;
- Mungesa e përkohshme e burimeve ekonomike dhe financiare për qëllime të biznesit;
- Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare" ;
- Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimitarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

NENI 24

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrat Tregtar.

NENI 25

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilive shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.



NENI 26

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe per gjithesish ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten ceshtjen mund të behet objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 27

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet udhezimeve plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Ortakeve si dhe legjislationi ne fuqi.

NENI 28

Ky statut u redaktua ne 2 ekzemlare me permabjtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e saj orgjinale.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

RAFFAELE ATTIANESE

RAFFAELE ATTIANESE

SAVERIO FRANCESCO VACCA

SAVERIO FRANCESCO VACCA

Asistoj si perdetar

Mihaliso Kom